




Majlinda Zorhaj
Nfuf



Alberte Byslesaj

Msiola Honoprah Mhuq



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2536 Prot.

Vlorë më, 06.11.2024

VENDIM

Nr. 60, datë 06.11.2024

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT, TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT NGA
MASTER PROFESIONAL, NË "MËSIMDHËNIE PËR CLAB NË GJUHË
ANGLEZE" NË MASTER I SHKENCAVE NË "MËSUESI NË GJUHË E HUAJ,
GJUHË ANGLEZE" PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh, nenit 75, 76, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Departamentit të Gjuhëve të Huaja si dhe relacionit të Zëvendësrektorit Akademik, përcjellë me shkresën 2428/3, prot, datë, 05.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.11.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, në Fakultetin e Shkencave Humane, për riorganizimin e të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Mësimdhënie për CLAB në gjuhë angleze" në Master i Shkencave në "Mësuesi në gjuhë e huaj, gjuhë angleze", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit Akademik, Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Humane, si dhe Drejtoria e Edukimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj.

